



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CC-2023-22

Vendosi: Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese
Gjykatës Vidar Stensland, Kryegjykatës
Gjykatës Roumen Nenkov
Gjykatëse Romina Inkuti

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 11 janar 2024

Gjuha: Anglishte

File name: Kërkesë Referuese e Nasim Haradinajt drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me Kërkesën Referuese të Mbrojtjes së Haradinajt drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese

Klasifikimi: Publik

Urdhër mbi Afatet për Dorëzimin e Parashtrimeve

Parashtruesit të Kërkesës
Nasim Haradinaj

Zyrës Administrative
Fidelma Donlon

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 21 nëntor 2023, z. Nasim Haradinaj ("parashtruesi i kërkesës") i paraqiti Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Dhoma")¹ një kërkesë referuese ("Kërkesa Referuese")² sipas neneve 31(2), 33(1) dhe 40 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 49(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullave 4(c) dhe 20 të Rregullores së Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Rregullorja e DHSGJK-së"). Parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga z. Tobi Kadman, znj. Almudena Bernabeu dhe z. Xhon Kabën.

2. Më 27 nëntor 2023, Dhoma lëshoi vendimin mbi, ndër të tjera, parashtrimet me shkrim në lidhje me Kërkesën Referuese ("Vendimi mbi Parashtrimet me Shkrim"),³ ku ftoi Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") që, në qoftë se dëshironte, të dorëzonte parashtrime me shkrim me jo më shumë se 8.000 fjalë, në lidhje me Kërkesën Referuese, deri më 22 janar 2024.⁴ Dhoma gjithashtu ftoi parashtruesin e kërkesës që, në qoftë se dëshironte, në kundërpërgjigjen ndaj ZPS-së, të dorëzonte parashtrime me shkrim me jo më shumë se 4.000 fjalë, brenda 21 ditësh nga dorëzimi i parashtrimeve me shkrim nga ZPS-ja.⁵

3. Më 27 dhjetor 2023, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi Dhomës një kërkesë për pranimin si provë të ankesës së një sinjalizuesi ("Kërkesa për Pranimin si Provë").⁶

¹ KSC-CC-2023-22, F00003, Vendim për Caktimin e Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese, 22 nëntor 2023, konfidencial, riklasifikuar si publik më 28 nëntor 2023, me Shtojcën 1, publike.

² KSC-CC-2023-22, F00001, Kërkesë Referuese e Mbrojtjes së Haradinajt drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, 21 nëntor 2023, konfidenciale, riklasifikuar si publike më 11 dhjetor 2023.

³ KSC-CC-2023-22, F00003, Vendim mbi Gjuhën e Punës, Parashtrimet me Shkrim dhe Versionin e Redaktuar Publik të Kërkesës Referuese, 27 nëntor 2023, publik.

⁴ Vendimi mbi Parashtrimet me Shkrim, Vendimi, para. 2.

⁵ Vendimi mbi Parashtrimet me Shkrim, Vendimi, para. 3.

⁶ KSC-CC-2023-22, F00005, Kërkesë Konfidenciale për Pranimin e Ankesës së Sinjalizuesit, 27 dhjetor 2023 (ballina e parashtrimit mban datën 22 dhjetor 2023), konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 28 dhjetor 2023), me Shtojcën 1, konfidenciale.

4. Më 5 janar 2024, ZPS-ja dorëzoi njoftimin me të cilin bëri të ditur se, në mungesë të një afati ligjor, synon t'i përgjigjet Kërkesës për Pranimin si Provë brenda afatit të caktuar për parashtrimet mbi Kërkesën Referuese ("Njoftimi i ZPS-së").⁷

5. Më 8 janar 2024, parashtruesi i kërkesës i paraqiti Dhomës një kërkesë me të cilën kërkoi një konstatim se Njoftimi i ZPS-së nuk kishte fuqi ligjore ("Kërkesa e Parashtruesit").⁸ Në këtë aspekt, ai pretendon se, sipas rregullës 1(2) të Rregullores së DHSGJK-së dhe rregullës 76 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, ZPS-ja, ose ishte e autorizuar ta dorëzonte përgjigjen brenda 10 ditësh nga Kërkesa për Pranimin si Provë, ose të dorëzonte në kohë një kërkesë për zgjatje të afatit për t'i lënë Dhomës kohë të mjaftueshme për marrjen e vendimi mbi kërkesën para përfundimit të afatit përkatës.⁹

II. VLERËSIMI I DHOMËS

6. Fillimisht, Dhoma informon ZPS-në dhe parashtruesin e kërkesës se i ka marrë parasysh siç duhet Njoftimin e ZPS-së dhe Kërkesën e Parashtruesit. Pasi shqyrtoi me kujdes parashtrimet e palëve, duke mbajtur parasysh rregullën 15(2)-(3) të DHSGJK-së dhe urdhrin e mëparshëm mbi afatet në Vendimin për Parashtrimet me Shkrim, Dhoma, në këtë kontekst, nuk e pengon ZPS-së që t'i përgjigjet Kërkesës për Pranimin si Provë brenda afatit të caktuar për parashtrimet e veta me shkrim mbi Kërkesën Referuese, konkretisht deri më 22 janar 2024. Gjithashtu, Dhoma fton parashtruesin e kërkesës që, në qoftë se dëshiron, t'i kundërpërgjigjet përgjigjes së ZPS-së lidhur me Kërkesën për Pranimin si Provë brenda të njëjtit afat të caktuar më herët për parashtrimin e kundërpërgjigjes së vet ndaj Kërkesës Referuese, konkretisht brenda 21 ditësh nga dorëzimi i parashtrimeve me shkrim nga ZPS-ja. Përgjigjja e ZPS-së dhe kundërpërgjigja nga parashtruesi i kërkesës, në qoftë se do të kenë, do të përmbliidhen

⁷ KSC-CC-2023-22, F00006, Njoftim në lidhje me Parashtrimin KSC-CC-2023-22/F00005, 5 janar 2024, publik.

⁸ KSC-CC-2023-22, F00007, Kërkesë mbi Njoftimin në lidhje me Parashtrimin KSC-CC-2023-22/F00005, 8 janar 2024, publike.

⁹ Kërkesa e Parashtruesit, para. 10-11.

në të njëjtin parashtrim me parashtrimet me shkrim të tyre në lidhje me Kërkesën Referuese. Ky konstatim nuk prek Kërkesën e Parashtruesit, e cila do të shqyrtohet nga Dhoma pasi të ketë marrë të gjitha parashtrimet nga palët.

7. Lidhur me këtë, duke pasur parasysh parashtrimet shtesë të lejuara për t'u paraqitur, Dhoma mendon se ZPS-ja mund ta tejkalojë numrin e fjalëve të përcaktuar fillimisht në Vendimin mbi Parashtrimet me Shkrim me deri në 600 fjalë. Gjithashtu, parashtruesit të kërkesës i lejohet të tejkalojë numrin fillestar të fjalëve për parashtrimet e tij me shkrim me deri në 300 fjalë.

Për këto arsye,

Dhoma e Gjykatës Kushtetuese

1. *Lejon* ZPS-në t'i përgjigjet Kërkesës për Pranimin si Provë së bashku me parashtrimet e veta me shkrim lidhur me Kërkesën Referuese, deri më 22 janar 2024;
2. *Fton* parashtruesin e kërkesës që, në qoftë se dëshiron, t'i kundërpërgjigjet përgjigjes së ZPS-së mbi Kërkesën për Pranimin si Provë, së bashku me kundërpërgjigjen e tij ndaj parashtrimeve me shkrim të ZPS-së lidhur me Kërkesën Referuese, brenda 21 ditësh nga dorëzimi i parashtrimeve të ZPS-së;
3. *Lejon* ZPS-në dhe parashtruesin e kërkesës të tejkalojnë numrin e fjalëve të caktuar fillimisht për parashtrimin e përgjigjes dhe kundërpërgjigjes ndaj Kërkesës Referuese, përkatësisht me deri në 600 fjalë dhe 300 fjalë; dhe
4. *Shtyn* marrjen e vendimit mbi Kërkesën e Parashtruesit deri pasi të ketë marrë të gjitha parashtrimet nga palët.

/nënshkrimi/

Gjykatës Vidar Stensland
Kryegjykatës

Hartuar në anglishte, e enjte, 11 janar 2024

Në Hagë, Holandë